**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË**

Nr. 1352/1 prot. Tiranë, më 12.07.2024

Lënda: Kthim përgjigje.

Në përgjigje të kërkesës Suaj dërguar me email më datë 09.07.2024, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) me nr. 1352, datë 09.07.2024, "Kërkesë për testim transformatorët e rrymës", Ju bëjmë me dije se:

Bazuar në VKM nr.1351, datë 3.10.2008, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara" dhe VKM nr. 770, datë 2.11.2016 "Për miratimin e rregullit teknik "Për instrumentet matëse", për disa ndryshime në vendimin nr.1351, datë 3.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kërkesat dhe metrologjike për instrumentet matëse, ligjërisht të kontrolluara", dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara", instrumenti të cilit Ju i referoheni në kërkesën Tuaj "transformatorët e rrymës" nuk janë pjesë e kësaj rregullore dhe DPM nuk ofron shërbim për të.

Gjithashtu në asnjë akt ligjor që lidhet me Metrologjinë (Ligje, VKM apo Urdhër) nuk gjendet asnjë përcaktim apo kërkesë që lidhet me transformatorët matës, për këtë arsye nuk përfshihet në shërbimet që kryen apo që mund të autorizoj Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Petrit Rama**

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë, web: www.dpm.gov.al, e mail: metrology@dpm.gov.al